

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit M. D., nga Gjakova, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar, nga neni 422 par. 1 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit M. D., T. B., av. nga Gjakova, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr. 251/2011 datë 29 dhjetor 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.142/2016 datë 4.5.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13 shtator 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit M. D., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr. 251/2011 datë 29 dhjetor 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.142/2016 datë 4.5.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për krime të rënda, PKR.nr. 251/2011 datë 29 dhjetor 2015, i dënuari M. D. është shpallur fajtor për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar, nga neni 422 par. 1 të KPK-së dhe për këtë veprë penale iu është shqiptuar dënimi i kushtëzuar me të cilin iu është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 3

vitesh nuk kryen veprë të re penale e në rast se vjen deri te revokimi i dënimit në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 3.03.2008 deri më 18.3.2008. I akuzuari është detyruar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 100 € në emër të shumës paushalle, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit, Gjykata e Apelit në Prishtinë ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë PKR.nr.251/2011 datë 29 dhjetor 2015, ndërsa përkritazi me të akuzuarin B. Z. dhe S. S., për pjesët liruese, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka ngelur i paprekur.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe atij të shkallës së dytë, mbrojtësi i të dënuarit M. D., T. B., av. nga Gjakova ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.111/2016 datë 27.6.2016 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par. 1\ dhe 436 par. 1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka gjetur se:

Kërkesat nuk janë të bazuara.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 225 par. 1 të KPPK-së i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjen së veprës penale për faktin se sipas kësaj dispozite hetimet duhet të përfundojnë në afatin prej 6 muajsh, ndërsa nga ana e Prokurorit nuk ka pasur kërkesë për zgjatjen e hetimeve, se konform dispozitës së nenit 159 të KPPK-së hetimi është dashur të përfundojë në afat prej 2 vitesh ndërsa konform dispozitës së nenit 157 të KPPK-së, nëse hetimet nuk kanë përfunduar procedura hetimore duhet të pushohet, se sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Dhoma e Posaçme , Scc.nr.08-

0237 të datës 15.12.2015 ndërmarrja e dëmtuar është trajtuar si shoqëri aksionare e si e tillë ka pasur mandat në vendosjen dhe menaxhimin e pasurisë.

Po ashtu, pretendon në kërkesë se nga dëshmitarët e dëgjuar vërtetohet vetëm për tentimet për shitjen e pjesëve të makinave të cilat kanë qenë jashtë prodhimit, ndërsa për një pjesë e cila është shitur është bërë pagesa e rojeve dhe punëtorëve të ndërmarrjes me shuma simbolike ndërsa nga ekspertiza e ekspertit H. B. jo vetëm që nuk është profesionale për faktin se makinat në aspektin e kontabilitetit kanë qenë të pa vlera nga ana tjetër nuk dihet koha e tjetërsimit. Po ashtu thekson se shkresa e Prokurorit Publik Komunal në Gjakovë të datës 3.7.2008 ishte akt i pabazuar në dispozita ligjore, se shitja e ndërmarrjes e bërë nga AKP-ja është joligjore meqë nuk ka pasur ingjerenca, ngase e njëjta ka qenë shoqëri aksionare.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes rrjedh se nuk janë kontestuese rrethanat se ndërmarrja “.....” nga Gjakova ka qenë pronë shoqërore, ndërsa me kthimin e ish punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje në vitin 2005 nga Kuvendi i punëtorëve, i dënuar M. D. është zgjedhur kryetar i Bordit menaxhues ndërsa në ndërkohë është shndërruar në shoqëri aksionare. Meqë ndërmarrja në fjalë nuk ka funksionuar – e dalë jashtë përdorimit, i dënuari në cilësinë e kryetarit të Bordit me Z. H. ka lidhur kontratë për shitjen e 100 tonëve të hekurit të nxjerrë nga mjetet themelore të ndërmarrjes. Nuk është kontestues fakti se për pjesën e shitur pagesa është bërë me para të gatshme në arkën e ndërmarrjes së dëmtuar. Po ashtu, nuk janë kontestuese rrethanat se AKM-ja më datë 12.11.2007 stafit menaxhues iu është drejtuar me shkresë me të cilën iu është urdhëruar ndërprerja e shitjes së aseteve të kësaj ndërmarrjeje. Nuk është kontestues as fakti se shkresë e ngjashme iu është dërguar edhe nga ana e Prokurorit Publik Komunal në Gjakovë të datës 16.6.2005.

Me pa mëdyshje janë vërtetuar rrethanat se firma “.....” në bazë të një kontrate të lidhur me të dënuarin, para ditës kritike më 29.2.2008, pasi që janë ngarkuar në automjet transportues pjesët e hekurta, me ndërhyrjen e organeve policore bëhet ndalimi i punës, ndërsa automjeti transportues me pjesët e hekurta të ngarkuara është sekuestruar. Nga deponimi i dëshmitarit Z. H. vërtetohen rrethanat se më parë 3-4 kamionë të ngarkuar me hekur, janë marrë nga ndërmarrja e dëmtuar e që këto rrethana nuk i konteston as i dënuari.

Qëndron fakti se sipas dispozitave të procedurës penale të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale – neni 225 par. 1 të KPPK-së, hetimet duhet të përfundojnë në afatin prej 6 muajsh, ndërsa nga shkresat e çështjes nuk shihet se ka pasur ndonjë kërkesë nga përfaqësuesi i akuzës për zgjatjen e hetimeve ndërsa akuza është ngritur më 7.3.2011 e që nga kjo rrjedh se bëhet fjalë për një shkelje të kësaj dispozite të procedurës penale e cila është e karakterit relativ, që nuk ka ndikuar në marrjen e vendimit gjyqësor për faktin se dispozita e nenit 224 në mënyrë taksative parasheh rastet e pushimit të hetimeve ndërsa dispozita e nenit 223 në mënyrë taksative parasheh rastet kur hetimi pezullohet kurse në asnjë dispozitë ligjore nuk theksohet se me kalimin e afatit të theksuar hetimet duhet të pushojnë.

Po ashtu, qëndron fakti se ndërmarrja e dëmtuar është regjistruar dhe trajtuar si shoqëri aksionare edhe sipas vendimit të Dhomës së Veçantë të gjykatës Supreme të Kosovës por këto janë rrethana irelevante për faktin se ndërmarrja e dëmtuar edhe para shndërrimit në shoqëri aksionare ka qenë dhe mbetet ndërmarrje shoqërore dhe se çdo veprim i ndërmarrë nga ana e të dënuarit ka qenë i kundërligjshëm për faktin se në bazë të Rregullores së UNMIK-ut NR. 2002/2012 i datës 13.6.2002 i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18 mbi themelimin e AKM-së andaj konform dispozitës së nenit 5.1 është i vetmi institucion me kompetencë për administrimin e ndërmarrjeve në pronësinë shoqërore dhe publike e cila ka për obligim ta ruaj dhe rritë vlerën e këtyre ndërmarrjeve.

Vlen të theksohet se shndërrimi i ndërmarrjes në shoqëri aksionare, siç theksohet edhe në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, kishte me pasur një kuptim pozitiv nëse mjetet e gjetura të ndërmarrjes do të destinoheshin në vazhdimin e prodhimit dhe veprimtarisë për të cilat kanë qenë të destinuara por jo edhe veprimet e ndërmarrja nga i dënuari në shitjen e mjeteve themelore të ndërmarrjes që thjeshtë bëhet fjalë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga i dënuari.

Përkritazi me shkeljet e Ligjit penal, për të cilat mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të parapara me dispozitën e nenit 385 të KPPK-së, e cila dispozitë në mënyrë taksative parasheh rastet kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është i përfshirë me këto shkelje, ndërsa në kërkesë nuk bëhet fjalë për asnjë nga shkeljet konform kësaj dispozite ligjore. Vlen të theksohet se cilësimi juridik i veprës penale është rezultat i vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike për çka pretendimet se është shkelur Ligji penal në dëm të të dënuarit është qartazi i pabazë.

Nga arsyet e lartcekura e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

PML.nr.152/2016 datë 13 shtator 2016

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa